



REPUBIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-36535 /2022

Klinë: 25-10 /2022

#### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 23. 09. 2022, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

**Pjesëmarrës në mbledhje janë kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, drejtorët e drejtorive, zyrtarë të tjerë, përfaqësues të OSBE, KFOR, OJQ-ve, qytetarë dhe media të ndryshme.**

Mbledhjen e rregullt të kuvendit të Komunës e hapi kryesuesi i kuvendit, z. Fadil Gashi. A i përshëndeti të pranishmit në mbledhje dhe ju uroj mirëseardhje. Në emër të kuvendit përshëndeti kryetarin e komunës, nënkryetaren, drejtorët e drejtorive, Komandantin e stacionit të Policisë në Klinë, përfaqësuesit OSBE-së dhe të tjerë prezent në mbledhje. Përshëndetje të veçantë ju bëri stafit të zyrës për punë të Kuvendit të cilët edhe pse janë në grevë kanë gjetur mirëkuptim dhe na e kanë organizuar mbledhjen e sotme duke qenë edhe prezent e në detyrë sot këtu me ne. Kryesuesi Gashi konstatoi se prezent janë 26 anëtarë të kuvendit dhe ka konfirmim që është duke ardhur në mbledhje edhe z. Armend Beqiri. Ai konstatoi se punimet mund të vazhdojnë. Në lidhje me rendin e ditës ai theksoi se Kam dy kërkesa. Kërkesa e parë është nga drejtoria e Urbanizimit që të hiqet pika e 9 nga rendi i ditës, e cila është- Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpallje zonë me interes publik e parcelës e cila e ka numrin e shënuar aty. Dhe kërkesa e dytë është nga kryetari i Komunës për një rast specifik për ndarjen e një shume prej 1000 eurove për znj. Nazife Callapeku për mbulimin e qirasë së banimit.

Për Rendin e Ditës, kryesuesi i Kuvendit hapi debat.

**z. Zafer Gashi:** Përshëndetje të gjithëve. Grupi kuvendar i LVV kërkon që duke e parë këtë rend dite i cili asnjëherë s' ka qenë me i copëtuar të futet edhe një pikë e rendit të ditës , me qellim që të i ikim shkeljeve ligjore. Unë po jua shpërndajë grupeve kuvendare nga një dokument që ta dinë se për çfarë është fjala. Janë tre dokumente, Ju lutem që të jemi operativ dhe të mos lejojmë edhe më tutje të bëhet shkelje e ligjit. Fjala është që të futet në Rend dite ndryshimi i statutit të QKMF-së. LVV do të i jep votat për ndryshim dhe plotësim të pikës në statut të QKMF-së ku flitet për zgjedhjen e drejtorit të këtij institucioni. Pra aty te kriteri për zgjedhjen e drejtorit ku thotë se duhet të jetë specialist i mjekësisë familjare të shtohet edhe tog fjalësh- Specialist edhe i fushave të tjera të mjekësisë dhe në këtë mënyrë nuk do të shkelet ligji sikurse është shkelur kur është zgjedhur drejtori i fundit. Lus grupin kuvendar të Aleancës që i ka 11 vota në kuvend , të i bëjmë bashkë edhe tre votat tona të LVV dhe ta bëjmë këtë ndryshim në Statut të QKMF-së.

**z. Esat Raci:** Edhe për mua është i paqartë ky Rend dite. Te pika ku thuhet shqyrtimi i draft buxhetit, e shoh që nuk është edhe miratimi i tij. Mund të jetë lëshim teknik por për mua është e paqartë. Kërkoj sqarime nga ju kryesues se a është për herë të parë përgatitja e draft buxhetit për dy vite? Po ashtu pika 8 e Rendit të ditës, komisioni për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. drejtorëve për institucionet arsimore, përkundër që kemi informacione se është kontrabanduar vota e anëtarëve të Kuvendit, ne nuk kemi asnjë emër të propozuar në materialin që na keni dërguar. Sa i përket propozimeve për heqje dhe shtesa të pikave të reja të pikave nga Ju dhe Zaferi, në Rend Dite, jemi plotësisht dakord.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Kërkesën e grupit të LVV nuk mund ta procedojmë. Nëse i referoheni akteve ligjore se si duhet të bëhet propozimi i ndryshimeve në statute dhe të tjera na i merr afërsisht dy-tre muaj. Nuk bëhet me një votim sot. Mund ta bëni një kërkesë dhe ajo kërkesë të vije fillimisht në KPF, pastaj lëshohet në debat publik dhe rrugë të tjera procedurale. Në fund vjen në Kuvend dhe këtu votohet plotësim – ndryshimi. Këto ndryshime që i kërkuat ju i kemi kërkuar edhe në kohën kur është miratuar statusi i QKMF-së por ka qenë udhëzimi administrativ që e ka përcaktuar atë pikë. Edhe pasi të iniciohet kërkesa për ndryshime e plotësim prap do të detyrohemi të bazohemi në udhëzimin administrativ. Sa i përket pikës së draft buxhetit, është lëshuar gabim teknik duhet të jetë edhe miratimi. Jemi brenda afatit ligjor dhe kështu e kemi proceduar gjithmonë draft buxhetin.

**z. Zafer Gashi:** Le të jetë e qartë se kjo është ditur edhe atëherë kur është hapur konkursi për drejtor të QKMF-së. Është bërë për të djegur një personalitet, profesionist.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Keni të drejt që të thirrni në interpelancë drejtorin e Shëndetësisë a kë të doni ju. Tani po flasim për Rendin e Ditës.

**z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë:** Vetëm për sqarim. Në vitin 2020 është hartuar drafti unik i QKMF-ve. Proceduralisht secila QKMF duhet ta bëjë plotësim-ndryshimin e statutit. Ne jemi në fazën kur e kemi bërë ndryshimin e statutit të vjetër të aprovuar në Kuvend. Si procedurë duhet të marrim miratimin në Ministri të shëndetësisë se a i jemi përmbajtur draft statutit unik. Pastaj e sjellim në kuvend Komunal, këtu jepni propozimet ju, del në diskutim publik dhe tutje me procedura.

**z. Valmir Bacaj:** Përshëndetje të gjithëve. Është mirë të qëndrojmë në Rend Dite e të mos kalojmë në tema të tjera. Sa i përket pikës ku shkruan vetëm shqyrtimi i draft Buxhetit kuptohet që është vetëm gabim teknik pasi që në rekomandimet e KPF-së është Shqyrtimi dhe miratimi. Pika 8, shqyrtimi dhe miratimi i komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. drejtorëve, kemi pranuar materialin shtesë nga drejtorja e arsimit ndërsa sa i përket propozimit të grupit të LVV, ne këtu kemi ndryshuar rregullore e statute por gjithmonë duke i respektuar udhëzimet administrative dhe ligjet në fuqi. Nuk është urgjente plotësimi dhe ndryshimi i statusit si dhe procedurat veç se u sqaruan.

**Znj. Valmira Krasniqi:** Përshëndetje për të gjithë. Unë dua të ndalem edhe tek pika 7 e cila thotë: shqyrtim dhe miratim i ndarjes së mjeteve prej 20 mijë euro. Kujt kanë me ju nda këto mjete? Duhet të ceket.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** I keni të specifikuar në material të gjitha.

**Kryesuesi e vuri në votim Rendin e Ditës me dy kërkesat e tij dhe me 27 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 1 e Rendit të ditës: Arsyetimi i mungesave**

Prezent janë 27 anëtarë të Kuvendit

**Pika 2 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluar. Një seancë e rregullt e fundit dhe një e seancës së jashtëzakonshme.**

**z. Zafer Gashi:** Ne nuk i kemi këto procesverbale që të i shikojmë sepse kemi pasur probleme teknike me adresën tonë elektronike. E diji që është në [përpjekje IT që të na rregulloj.

**Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme me 24 vota për asnjë kundër dhe 3 abstenime (LVV) abstenime dhe pa asnjë vërejtje U MIRATUA.**

**Procesverbali i mbledhjes së rregullt e fundit e kuvendit me 24 vota për, 3 abstenime (LVV) dhe asnjë kundër U MIRATUA**

**Pika 3 e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.**

Kryesuesi, z. Gashi theksoi se prej të gjitha rekomandimeve që tani më i kanë asamblastët, janë në rendin e ditës. Ato që nuk janë në rend të ditës janë adresuar në drejtoritë përkatëse. Është një kërkesë për znj. Sevdije Ismaili e cila ka bërë kërkesë për ndihmë për shërim, KPF e ka aprovuar por ka mbetur që të vendosë Kuvendi. Drejtoria e Financave është mirë që të na ndihmoj për kufijtë e mundësive.

**z. Esat Raci:** rreth kësaj kërkesë pajtohem plotësisht me rekomandimin e KPF.

**z. Valmir Bacaj:** Si grup Kuvendar ne mendojmë që të shkojmë në pako të votimit të rekomandimeve përveç kërkesës së 5 e cila është hequr. Përndryshe edhe ne pajtohem me rekomandimin e KPF për kërkesën në fjalë.

**z. Ndrecë Zefaj:** Edhe ne si grup kuvendar i LDK e mbështesim këtë kërkesë.

**z. Zafer Gashi:** LVV jo vetëm që e mbështet këtë kërkesë por inkurajon kryetarin që rastet e tilla të mbështeten. Për këso rastesh ne si grup gjithmonë do të votojmë pro.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Edhe unë mendojë që këtë kërkesë ta adresojmë në zyrën e kryetarit dhe të trajtohet sikurse rastet e tjera që janë trajtuar. A Pajtohen me këtë?

**Me 27 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pas kësaj kryesuesi i vuri në votim në pako rekomandimet e KPF-së dhe me 27 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 4. Shqyrtimi i raportit nga dëgjimet publike në lidhje me draft buxhetin 2021-2025**

Kryesuesi hap debat

**Pasi nuk kishte të interesuar për debat kryesuesi e vuri në votim dhe me 27 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtim i dhe aprovim i draft buxhetit të komunës për vitet 2021-2025.**

**z. Ajet Sejdiu, u.d. i drejtorit të FEZH:** Përshëndetje të gjithëve. Drejtoria e Financave duke u bazuar në ligjin për financa në fuqi dhe gjitha dokumentet e tjera ka hartuar draft buxhetin që ju e keni përpara. Misioni i Komunës së Klinës është zhvillimi ekonomik lokal duke synuar ambient të sigurt dhe tërheqë

për investitorët, zhvillim të bizneseve të vogla dhe të mesme etj. Gjatë kësaj kohe kemi zhvilluar dëgjime publike në tërë ambientet e komunë sonë. Këshilltar të nderuar në vitin 2023 buxheti komunal subvencionohet nga grandet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Këto dy kategori kanë rritje mesatare. Në vitin 2023 buxheti komunal nga grandet do të jetë 13 milion e 51 mijë e 595 euro, ndërsa ai i të hyrave vetanake do të jetë- 1 milion e 373 mijë e 774 euro. Siç e shihni edhe projektet kapitale në këtë vit kanë rritje si dhe kategoritë e tjera buxhetore. Shpenzimin më të madh të buxhetit për këtë periudhë do ta bëjë kategoria Pagat dhe mëditjet. 6 milion e 753 mijë e 638 euro për 956 të punësuar në sektorin publik. Ky buxhet ka për qëllim për të përmirësuar jetën e qytetarit në të gjitha sferat. Aty keni edhe listën e projekteve që planifikohen për të u realizuar. Janë dy ndryshime tek projektet. Një është tek fshati në Jashanicë që është harruar që të shënohet emri. Është rruga "Afrim Haliti" që do të asfaltohet dhe e dyta janë disa mjetet që janë vendosë në drejtorin e Urbanizmit. Këto janë disa ndryshime që ju nuk i keni në material. Po ashtu edhe tek stafi i punëtorëve në Drejtorinë e arsimit që është bërë një ndryshim. Faleminderit për vëmendje.

#### Hapet Debat

**z. Arben Limanaj:** Përshëndetje. Kemi përpunuar pjesën e buxhetit në fjalë dhe themi se pjesa më e madhe e vendbanimeve në komunë tonë janë përfshi në këtë buxhet por më duhet të shprehë disa shqetësime që ne si grup i kemi. Ne si grup kuvendar në asnjë mandat nuk kemi votuar kundër buxhetit. Fshatin nga vij unë selektohen lagje të caktuara që mos të asfaltohen rrugë ndërsa familje që nuk bëjnë hiq kërkesë për me ju asfaltuar rruga, atyre megjithatë ju shtrohet. Pavarësisht kësaj ne prap do ta mbështesim buxhetin e Komunës. Pres nga grupi që të angazhohen edhe këta në vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Sa i përket kulturës unë e diji që për lokalitetin arkeologjik është nda buxhet viteve të më hershme ndërsa në këtë buxhet nuk e shoh që është nda buxhet. Po ashtu kam edhe një kërkesë për një shtëpi në fshati Bokshiq e cila njihet si shtëpia e kuvendeve ku janë mbajtur në të kaluarën aktivitete e mbledhje të shumta të forumeve të ndryshme. Ne kërkojmë që renovimi i kësaj shtëpie të futet në projektet për bashkëfinancim.

**z. Zafer Gashi:** Si gr. Kuvendar i LVV ne kemi dhënë kërkesat tona që në muajin qershor kur ka qenë në diskutim ky draft. Në atë që e shohim asnjë nga kërkesat e tona nuk janë marrë parasysh. Është bërë një ndarje jo proporcionale. Nuk e diji se si ka mundësi që për tre vjet të harrohet një fshat i tërë. Ndoshta sepse s' ka votues të Aleancës si fshati Resnik ose Kpuz. Ky draft buxhet nuk do të jetë zhvillim ekonomik çfarë synojmë. Ne do të votojmë kundër buxhetit si grup. Çdo votë tjetër që del pro nga grupi ynë është votë individuale.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Unë ju inkurajoj që të jepni sugjerime sepse këtu është vendi për të ngrit zërin. Le të diskutohet e debatohet gjithmonë. Ekzekutivi po ka problem se në dëgjime publike po mungon masa. Nuk po ka të interesuar që të marrin pjesë në shqyrtimin dhe debatin për buxhet.

**z. Kushtrim Haliti:** Përshëndetje. Pas shqyrtimit të buxhetit i kam nda tre fshatra. Së pari unë e përgëzoj Tunë Dedajn që ka arrit me marr afërsisht 370 mijë euro për pjesën e vet nuk e paskam dijtë që është më i forti në Aleancë. Mendoj që është buxhet shumë i tepërt i ndarë për këto tre fshatra duke e ditur që është investuar edhe në mandatin e kaluar. Po ashtu edhe Videjë, Polce dhe Krushevë e Madhe, edhe këtu mendoj që është buxhet i tepërt derisa ka fshatra ku nuk janë nda fare buxhet siç është Resniku, Dushi, JAshanica. Në Shtupel, Bingjë dhe Grapc janë nda 360 mijë euro. Rruga që është planifikuar të shtrohet përveç në Gjurgjevik të Vogël që është e dëmtuar, në Bingjë ose Grapc nuk diji kujt doni me i shtruar atje. Në Grapc nuk jeton askush ndërsa në Bingjë është vetëm një shpi, ajo e Stojan Doncicit i cili

gjatë kohës së luftës ka luftuar kundër popullatës Shqiptare, është edhe video në Youtube. Është lagja Selmanaj e cila nuk mund të kalojë nëpër Shtupel për me ardh në Klinë sepse nuk jua keni shtruar rrugën po detyrohen me kaluar nëpër Kerrnicë. Kur e ka pas llogaritë drejtori i Urbanizmit në debat publik se sa kushton për asfaltimin e rrugës " Afrim Haliti" pat qenë shuma prej 250 mijë eurove, ndërsa këtu shoh që për tre fshatra, Jelloc, Resnik dhe Jashanicë keni planifikuar vetëm 120 mijë euro për vitin 2023 ndërsa në 2024 dhe 2025 zero investime. S' di qysh mund të kryhet kjo. Edhe ura në Pogradjë është rritur komplet dhe nuk mund të kalojë as këmbë.

**z. Ajet Sejdiu, u.d. Drejtorit të FEZH:** Kemi shumë raste që nuk kemi mjaftë buxhet por ne kemi të hyra vetanake dhe i plotësojmë me mjete shtesë. Në rajonin e Jashanicës janë 240 mijë të planifikuara.

**z. Kushtrim Haliti:** Po thuhet 240 mijë euro por në vitin 2024 dhe 2025 nuk figuron fare Jashanica me këto fshatra.

**z. Esat Raci:** Ne si grup Kuvendar kemi marr vendim që të abstenojmë në lidhje me votimin e këtij Buxheti por çdonjëri nga ne e ka vendimin e vet personal. Nuk jemi kundër zhvillimit ekonomik të komunës as kundër buxhetit por janë disa arsye. Kemi bërë në 2021 projekte dhe jua kemi dorëzuar pasi keni kërkuar nga ne por nuk i keni marr për bazë fare. Uji i pijshëm nuk shohë që keni planifikuar buxhet edhe pse vazhdimisht ka qenë premtim i kryetarit. Po ashtu premtim elektoral ka qenë edhe stacioni i autobusëve që si duket tani ka mbetë vetëm si parkim. Investimet që janë bërë deri me tani janë bërë vetëm për marrje të votave, pa mbikëqyrje profesionale. Projektet nëpër fshatra nuk janë specifikuar për arsye se kur të vijë koha për realizimin e atij projekti të pa specifikuar se në cilën lagje do të bëhet, do të kryhet vetëm në atë pjesë të fshatit ku i ka votat kryetari. Ura në Pogradjë që lidh 7 fshatra nuk e keni pa të arsyeshme që të ndërtohet. Qëndrimin tonë si grup kuvendar jua bëra publik.

**z. Asdren Ramadani:** Përshëndetje. Unë vazhdimisht kam bërë kërkesë nga kryetari që të realizohet projekti i urës në Rastokë. Tani projekti ka filluar, falëmirëditë kryetar dhe vota ime do të jetë pro këtij buxheti. Sa herë që kërkesat e mija realizohen për qytetarin, vota e ime do të jetë pro buxhetit.

**z. Valmir Bacaj:** Buxheti është për qytetarin dhe në të mirë të qytetarit. Është një buxhet që garanton investime në të gjitha lokalitetet e komunës pa dallim. Ky buxhet është shqyrtuar edhe në KPF. Jemi të vetëdijshëm që është buxhet i vogël dhe nuk i përmbush të gjitha kërkesat e nevojshme por kemi një buxhet që mbështete në mundësitë që kemi. Duhet të jemi të kujdesshëm me propozimet që bëhen që mos dalin jashtë mundësive pasi që duhet ta kemi parasysh se nga qeveria kemi zero investime. Ndarja e mjeteve prej 170 mijë euro për fshatin Zajm është për ndërtimin e trotuareve deri tek varrezat e qytetit në Zajm, është një rrugë alternative që lidhë me magjistralen dhe këto investime janë në shërbim të qytetarëve. Duke i marr për bazë të gjitha këto ne si grup jemi pro këtij buxheti.

**z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje. Buxheti i ndarë për Zajm është 170 mijë euro për trotuarin deri te varrezat e qytetit. Në Videj nuk ka kanalizim, kërkoj me u ndërtuar trotuari nga "Baci Petrol" deri në Krushevë, Rruga në Polce etj. Kam me u angazhuar gjatë këtij mandati që asnjë shtëpi në Klinë të mos mbetet pa kanalizim dhe rrugë të asfaltuar. Kam me u angazhuar bashkë me ty z. Haliti që edhe Jashanica të bëhet sikurse fshati Zajm.

**z. Enver Gashi:** Përshëndetje. Këto projekte të parapara për vitet 2023-2025 janë projekte gjithëpërfshirëse dhe plotësisht i përkrahu. Por duke i marr për bazë kërkesat e shumta unë si përfaqësues i qytetarëve kërkoj që shikohet mundësia buxhetore që në 2023 ndërtimi i infrastrukturës

nëntokësore Sferk-Volljak-Qupevë ku janë të parapara 100 mijë euro të shtohen 150 mijë, si dhe në vitin 2025 ku janë të parapara 100 mijë të shtohen edhe këtu 150 mijë . Arsye është sepse bashkësia e jonë lokale është Bashkësia më e madhe në Komunën e Klinës.

**Znj. Marigona Raci:** Përshëndetje. Buxheti që është ndarë për fshatrat Siqevë, Ujmir dhe Shtaricë, kërkesa e qytetarëve është që ky buxhet të rritet. Të investohet në QKMF në barnat esenciale gjithashtu.

**Znj. Lirie Gashi:** Përshëndetje për të gjithë. Sot është një ditë e rëndësishme për komunën tonë. Sot do të miratohet ose jo draft buxheti për vitet 2023-2025. Mendoj se draft buxheti nuk është çështje politike por interes i çdo qytetari i çdo shoqërie në Komunën tonë. Mos të harrojmë se të ky draft buxhet shohim zërat e qytetarëve, shohin interesat dhe nevojat e tyre. Falë këtyre qytetarëve ne jemi këtu. Prandaj jua kemi borgj kujdesin për ta. Kërkesat e tyre janë shumë të ndryshme dhe shumë të nevojshme. Rrugët, trotualet, ndërtimin e shkollave, parqeve, çerdheve etj. Lutem që në komunën tonë të ketë punësime reale pa ndikim politik , lutem që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë në trajtimin nga Komuna. Nuk është se jemi të kangur komplet me këtë buxhet sepse shumë lagje dhe fshatra nuk janë përfshi fare në këtë buxhet por shpresojmë që në të ardhmen të rregullohen dhe plotësohen e qytetarëve. Me e rëndësishmja dhe elementarja- Uji i pijshëm shpresoj që do të rregullohet gjithashtu. Të nderuar të punojmë së bashku e kemi më lehtë dhe më mirë.

**z. Kushtrim Haliti:** Dëshiroj që ta pyes drejtorin e Bujqësisë se a është paraparë në këtë draft buxhet hapja e kanaleve dhe pastrimit të lumenjve që po na i dëmtojnë tokat bujqësore. Ndërsa pyes edhe një herë drejtorin e financave se a është shtuar buxhet për Jashanicë për vitin 2023-2025? Nëse po atëherë llogaritni edhe në votën time Pro.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Përshëndetje të nderuar. Besoj që hartimi i raportit nga takimet me qytetarë është praktikë e re dhe e para e këtij lloji e nga kjo të jepen rekomandime që kërkesat e qytetarëve të inkorporohen në kornizën afatmesme buxhetore tashmë të aprovuar. Unë jam munduar të mbaj shënime gjatë këtij debati. Sa i përket Caravikut dhe ajo që tha Arbeni , ka të drejt sepse çmimet janë rritur shumë dhe në vend të 3 km rrugë të planifikuar për asfaltim na është dashtë ta zvogëlojmë në një km. Mirëpo me rishikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm të gjitha rrugicat dhe kanalizimet do të përfundojnë në Caravik. Mendoj që e kemi treguar me veprime e projekte që asnjëherë nuk është diskriminuar askush shkakut i përkatësisë partiake. Sa i përket Resnikut, fshati Resnik është përfshi në këtë buxhet ndërsa Kpuzi mendoj që nuk ka kërkesa infrastrukturore por sidoqoftë unë jua kam dërguar draft buxhetin edhe shefave të partive politike e edhe KAB dhe kam qenë dhe jam i gatshëm që për çdo kërkesë të debatojmë dhe të gjejmë zgjidhje edhe sot, edhe tani, nëse anëtarët e kuvendit janë të interesuar. Ajo që tha kushtrimi për Binjë, janë vetëm 50 mijë euro dhe nuk e diji a do të shpenzohen gjitha sepse kanalizimi nisë në shtupe , kalon në Kerrnicë e kur shkon në Bingjë pastaj. Unë kam propozim konkret për Jashanicë. Që nga bashkëfinancimi të hiqet vlera dhe të qitet në Jashanicë, Resnikë, etj diku 150 mijë euro. Ura në Pograhë është në proces për tu ndërtuar. Zgjerimi shtratit të Lumit në Shtaricë është në tenderim, ai problem që theksoi Kushtrimi do të evitohet. Investimet në Ujmirë, Siqevë, etj do të bartet komplet investimi dhe mendoj që do të kompletohet. Mendoj që investimet në 2023 do të koncentrohet më shumë në qytet. Sa i përket Ujit të Pijshëm është shqetësim por Komuna i ka 250 mijë euro në procedurë dhe përkundër pengesave me ministrinë përkatëse mendoj që do të sanohet shumë shpejt kjo ngecje dhe do të përfundoj ky projekt.

**z. Zafer Gashi:** Thatë që Fshati Resnik është i përfshirë në Buxhet, ju lutem ma gjeni në cilin vit dhe ku shkruan që është ndonjë projekt për fshatin Resnik. Sa i përket Ujit, disa herë jeni lidhur me atë

fundërruesin që e quan ti, do të shohim kur do të përfundoj. Po mendoj që nuk janë duke u mbajtur gjitha ato premtime e shkrime te bukura që ju i postoni dhe i vendosni nëpër tabela. Patet bërë shumë foto të bukura duke realizuar projektin e Ujëvarave, tani jeni orientuar këndeje nga ndërtimi i shtigjeve për ecje nga Pograxha, çfarë ndodhi kryetar? U harru projekti i Ujëvarave? Po ashtu edhe çështja e stacionit të autobusëve që vazhdimisht e kemi theksuar edhe ne këtu edhe ju gjithashtu, akoma nuk përfundoj. Ju lutem të jeni më preciz në atë që thoni që edhe ne të bindemi.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Fshatin Resnik e gjeni tek numri 14- Jashanicë, rruga "Afrim Haliti"- Resnik kur edhe i shtuam vlerën buxhetore. Ujëvarat e Mirushes është projekt i Ministrisë së Mjedisit , ata e kanë kontraktuar , ata e kanë buxhetuar dhe ne nuk po mund të ndërhyjmë. Për ujin e pijes ne i kemi nda 200 mijë euro por ka pasur vonesa nga buxheti prej ministrisë. Është formuar një komision edhe nga kryeministri për këtë çështje , është hartuar raporti dhe i është dorëzuar dhe mendoj që edhe 200 l/s përveç këtij 100 l/s që ka sot fabrika për përpunimin e ujit. Për këtë projekt shtesë është paraparë që të hartohet një studim detal. Parku i Sferkes i kemi në zotim dhe në fillim të procedurave për të gjitha parqet, kemi një problem aty tek varrezat e fshatit por mendoj që shumë shpejt do ta zgjedhim.

**z. Ndrecë Zefaj:** Përshëndetje. E kam lexuar këtë draft buxhet dhe e kam parë që nuk ka dallim të madh nga draft buxheti i muajit qershor. Në bujqësi nuk ka mjete shtesë për tu përkrahur, Mendoj që Bujqësia është më shumë se të tjerat e rëndësishme për komunën tonë. Në projeksionet e vitit 2024 dhe 2025 kemi ulje të buxhetit për bujqësi. Në përgjithësi është një shpërndarje relativisht e mirë i buxhetit por unë ju sugjeroj që të keni kujdes në kualitetin e punimeve.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Për Bujqësinë ne këtë vit kemi një memorandum bashkëpunimi dhe ata i kanë ndarë 300 mijë euro prandaj kjo është arsye që ne nuk kemi shtuar buxhet. Mbetet pa e përmendur edhe atë që e tha më herët Arben Limanaj për shtëpinë e Kuvendit në Bokshiq, ne do të kujdesemi që të përfshihet në grandet e qeverisë por nëse jo atëherë vitin e ardhshëm do ta mbulojmë vet ne investimin në atë shtëpi. Shpresojmë që përmes grandit të performancës të fitojmë dhe të marrim grandin ku më pastaj bashkërisht do të vendosim për investimet e më tutjeme.

**z. Arben Limanaj:** Kam vetëm një kërkesë. Duam ta dimë sot se a do të futet si projekt në këtë buxhet investimi në atë shtëpi.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Projekti i investimeve në shtëpinë e Kuvendeve në Bokshiq mund të futet dhe në vitin e ardhshëm të realizohet, nuk na krijon vështirësi pro ne duhet që të kontaktojmë me ministrinë Kulturës dhe të shohim se a mund ta realizojnë ata. Pra të shohim njëherë se a mund të realizohet nga Ministria e Kulturës e nëse ajo nuk ka mundësi atëherë e bëjmë ne pa asnjë problem vitin e ardhshëm.

**Znj. Fatjona Gashi, drejtore e DKRS:** Përshëndetje. Ne paraprakisht duhet të kujdesemi që ajo shtëpi të futet në listën e monumenteve kulturore dhe të vazhdojmë me investime .

**z. Arben Limanaj:** Dua të di nëse kulla e Mujë Krasniqit është trashëgimi kulturore, a është futë si monument në këtë listë?

**z. Fatjona Gashi, drejtore e DKRS:** Po kulla e Mujë Krasniqit është monument kulturor i futur në listën e objekteve të trashëgimisë. Ne duhet të kujdesemi që të gjitha monumentet e tjera të futen në listën dhe aprovohen si monumente të trashëgimisë Kulturore.

**z. Ajet Sejdiu, u.d. i drejtorit të FEZH:** Sa i përket shtëpisë së kuvendeve në Bokshiq, ne mund ta konfirmojmë që tani se kemi mjete të mjaftueshme për të investuar aty dhe ta konsideroni si të kryer.

**Kryesuesi e vuri në votim draft buxhetin dhe me 20 vota për , 5 abstenime, dy kundër, U MIRATUA**

**Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të takimit të kryetarit me qytetarë.**

**Me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndarjen të mjeteve në shumën prej 20 mijë euro.**

Kryesuesi theksoi se është një kërkesë për ndarje të mjeteve prej 20 mijë euro për blerjen e pajisjeve teknologjike për nevojat e stacionit policor në Klinë. Kryesuesi në vazhdim bëri përshkrimin në detaje se çfarë pajisje do të blihen si dhe shpjegoi procedurën e konsultimeve me ministrinë e punëve të brendshme dhe relacionit të këtij bashkë komunikimi që në përfundim u sqarua se nuk ka asnjë pengesë për marrjen e një vendimi për ndarjen e mjeteve.

**z. Valmir Bacaj:** Këtë kërkesë e kemi pasur edhe në seancat e kaluara dhe kemi kërkuar sqarimin e nevojshëm. Pas sqarimit që kemi marruar jemi pro këtij vendimi.

**z. Esat Raci:** E përkrahim si grup këtë kërkesë

**z. Arben Limanaj:** Edhe ne si grup e mbështesim këtë vendim

**z. Zafer Gashi:** Edhe grupi ynë e përkrahë këtë vendim

**Me 22 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

**Pika 8 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të institucioneve arsimore.**

**z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA:** Faleminderit. Bazuar në udhëzimet administrative DKA propozon dy anëtarë për këtë komision: Astrit Muhaxheri dhe Lorenc Culaj. Paraprakisht i jemi drejtuar drejtorisë së pushtetit lokal që të marrim konfirmimin e rregullsisë por ata na kanë sugjeruar që ne të bazohemi në udhëzimet dhe ligjin në fuqi.

**z. Arben Limanaj:** Është i njëjti komision që ka qenë propozuar edhe më parë dhe nuk ka marr votat e nevojshme. Askush nuk na ka konsultuar ndërkohë dhe ne kemi nevojë një pauzë 15 minutash që të konsultohemi si grup.

**z. Esat Raci:** Ne nuk do të marrim pjesë fare në seancë në këtë pikë sepse janë të njëjti anëtarë të propozuar në seancën e qershorit dhe jemi të njëjtit anëtarë të kuvendit që kemi votuar kundër. Asnjë gjë personale nuk kemi me dy kandidatët e propozuar por mendojmë që këta dy kandidatë nuk i plotësojnë kriteret sipas udhëzimit administrativ për këtë çështje. Nëse ky komision votohet dhe merr aprovimin e kuvendit ne si grup do të vazhdojmë të shtjerrim të gjitha rrugët ligjore që ky komision të mos bëhet i ligjshëm.

Shefi i grupit kuvendar të AAK, z. Valmir Bacaj propozoj që të hidhet në votim ky komision i propozuar sepse nëse ka shkelje atëherë ministria e pushtetit lokal do të na e kthej vendimin.

z. Zafer Gashi kërkoj që mos të qitet kuvendi para aktit të kryer sikurse ka ndodhur në të kaluarën. Ai kërkoj që mos të shkelet ligji sikurse është bërë me rastin e përzgjedhjes së drejtorit të QKMF-së. Kriteret sipas tij nuk janë plotësuar.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Mua më shqetëson ajo që tha drejtori i DKA për përgjigjen nga ministria që ka thënë që të veprohet sipas udhëzimit administrativ. Kjo po ndodhë edhe në shumë raste të tjera, As nuk ët thonë që e ke mirë as keq. Unë po aprovoj kërkesën e Arbenit për një pushim prej 15 minutave.

**Pushim 15 minuta**

**Pas pushimit prej 15 minutave, kryesuesi e vuri në votim komisionin e propozuar dhe me 15 vota për, 2 kundër dhe 3 abstenime U MIRATUA.**

**Pika 9 e Rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimeve sipas shkresës së MAPL**

Janë dy shkresa që duhet të i anulojmë theksoi kryesuesi. Njëra është vendimi për ndarjen e mjeteve në shumën prej 10 mijë euro për DKRS, që në pasuesin e fundit thuhet: ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Malishevës. Këtë shkresë e ka dërguar ministria e financave që duket se është vetëm copy-past.

**Me 20 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U Shfuqizua**

Vendimi dytë është vendimi që kemi marrë për banesat dhe raportin e komisionit të krijuar nga ekzekutivi.

**Me 20 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U SHFUQIZUAR edhe ky vendim.**

**Pika e 10 e Rendit ët Ditës: Kërkesa e kryetarit të Komunës për ndarjen e mjeteve prej 1000 euro për znj. Nazife Qallapeku.**

**Me 20 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.**

**Pika 11 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje**

**z. Zafer Gashi:** kam pyetje për drejtorin e Urbanizimit. Më intereson se a jeni të informuar që kanë filluar disa lëvizje nga operatori për ndërtimin e fabrikës së çimentos.

**z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit:** Faleminderit për pyetjen sepse kisha nevojë të sqaroj për atë që ka ndodhur javë më parë në këtë çështje. Kemi marr informacion se operatori ka lëvizur duke bërë rrethojën etj. që nuk është punë e jona por e një institucioni tjetër ndërsa sa i përket investimit në ndërtim të fabrikës jo s` ka pasur asnjë lëvizje. Reagimi i juaj ka qenë i pa saktë nëpër rrejte sociale.

**z. Zafer Gashi:** Faleminderit në përgjigje. Është mirë që sqaruat qytetarët me aq sa qëndron ai sqarim. Reagimet janë normale, s a i përket kësaj ju duhet të bëheni gati të përballoheni më të gjeturat e komisionit për hetimin e procedurave.

**z. Valmir Bacaj:** Dëshiroj të bëjë një reagim. Unë jam anëtar i atij Komisioni, nuk është mirë me manipuluar dhe me u thirr në një raport që nuk është kryer akoma.

**z. Zafer Gashi:** Unë jam pjesë e atij komisioni dhe unë kam vënë nënshkrimin në fund të atij raporti, nuk janë të gjeturat gjitha në mandatin e tij, shumica e të gjeturave janë nga mandati i drejtorit para z. Berisha.

**z. Tunë Dedaj:** Kam një pyetje për drejtorin e Urbanizimit në lidhje me projektin e ndërtimit të shtratit të lumit "Drini i Bardhë" në fshatin Deiq ka ndaluar. Pse ka ngecur dhe a do të rinisë?

**z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit:** Projekti ka nisur në vitin 2017 dhe ka vazhduar deri aty. Si duket operatori nuk po arrin që ta përfundoj dhe ne do të marrim masat sipas ligjit.

**z. Arben Limanaj:** Dëshiroj ta ritheksoi një çështje që e kam thënë para dy viteve në asamble. Dy shkollat, Në Grabanicë dhe në Resnik, prona ku është ndërtuar shkollat nuk janë pronë publike por private. A mund të rregullohet kjo çështje sepse e diji që në Resnik ka pasur shqetësime.

**z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës:** Pothuajse shumica e shkollave akne probleme me pronën e ku janë ndërtuar. Do të duhej që drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe ta rregulloj sa më shpejt. Janë disa konteste por drejtoria duhet at trajtoj këtë problematikë.

Me përfundimin e pyetjeve të anëtarëve të kuvendit në pikën e fundit të rendit të ditës, kryesuesi duke falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontribut e shpalli të mbyllur seancën.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

